UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS
Lënda: **Bazat e Statistikës**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Statistikë
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë, semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës: **Assistentët:**	Prof.Ass.Dr. Xhevat Sopi
Detajet kontaktuese:	xhevat.sopi@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	Kursi është i dizajnuar që të ju ofrojë studentëve njohuri të plota mbi konceptet dhe metodat bazike të statistikës dhe aplikimin e tyre në kontekstin e ekonomik e biznesor. Lënda "Statistikë" përmban informata dhe njohuri të rëndësishme teorike dhe praktike dhe të teknikave dhe metodave të ndryshme statistikore, të fokusuara në statistikën përshkruese, seritë kohore dhe konceptet e probabilitetit. Në përmbajtjen ë lëndës përfshihen kapitujt të rëndësishme si për sa i takon: Kuptimit të elementeve të analizës statistikore; Fazat e studimit statistikor; Llojeve e të dhënave; Mënyra e mbledhjes, grupimit dhe analizimit të të dhënave; Matësit e tendencës qendror (madhësitë mesatare algjebrike dhe të pozicionit); Treguesit e variacionit të karakteristikës në serinë statistikore; Analiza dinamike (indekset dhe trendi); Nocione themelore te probabilitetit; etj
Qëllimi dhe objektivat	**Qëllimi** i kursit të statistikës është që studentë të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetencë për të grumbulluar e analizuar të dhëna dhe për të interpretuar rezultate statistikore nga problemet të jetës reale nga fusha ekonomike.

	Objektiva të kursit janë që: - Tu jepet studentëve njohuri të mjaftueshme mbi elementet-konceptet kryesor të analizës statistikore, duke filluar nga njësia statistikore deri te popullimi - Studentët të njohin mirë të dhënat, llojet e tyre dhe metodat e grumbullimit dhe analizimin e tyre - Studentët të njohin metodat dhe treguesit e statistikës përshkruese për të aplikuar në analizën e e të dhënave. - Studentët të njohin metoda të analizës dinamike të të dhënave, siç janë indekset dhe metoda e trendit. - Fitojnë njohuri bazike mbi konceptet e probabilitetit dhe aplikimin.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimin me sukses të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje: - Të definoj elementët statistikorë, të identifikojnë variablat-karakteristikat dhe të njohë treguesit statistikore për analizën ekonomike; - Të dizajnojë dhe organizojë mbledhjen dhe grupimin e të dhënave - Të zgjedh metodat më të përshtatshme për analizimin e rezultateve.; - Të demonstrojë aplikimin e metodave statistikore, analizimin dhe interpretimin – prezantimin e rezultateve. - Analizojë dhe krahasojë rezultatet të ndryshme statistikore nga të dhëna primare apo sekondare, përkatësisht nga informacionet publike ekonomike. - Të përdorin kompjuterin (së paku Excel-in apo edhe softverë tjerë statistikorë) për të përpunuar të dhënat dhe prezantuar rezultatet.

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithsej**
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Kollokviume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	3	5	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	5	7	35

Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	3	9
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	6	2	12
Totali		**7 ECTS*25 =175 orë**	**175**
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 7 ECTS, kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 200 orë.			

Metodologjia e mësimdhënies:	Metoda e punës **gjatë ligjëratave** do të përqendrohet në ligjërata dhe diskutime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimit, duke u bërë pjesë e zgjidhjes së probleme që shtrohen, në mënyrë që të mund të fusin në funksion njohuritë që jepen në kapitujt aktual. Gjatë ligjëratave do të inkurajohet veçanërisht diskutimi nga ana e studentëve në rastet e dilemave për zgjidhjen e mënyrës më të përshtatshme e që në këtë lëndë ka mjaftë të tilla. **Gjatë ushtrimeve** forma e interaktivitetit dhe rolit të studentëve do të jetë edhe më e madhe, ku çdonjëri nga ta do të duhet të jetë pjesë ushtrimit dhe zgjidhjes së problemeve. Në ushtrime studentët do të inkurajohen që vetë të mbledhin të dhëna, të krijojnë seritë e tyre statistikore dhe në të dhëna reale të aplikojnë metodat statistikore. Ata do të bëjnë prezantime të rezultateve para kolegëve dhe do të nxitet diskutimi në grup për ato rezultate. Për çdo kapitull do të organizohen demonstrime në Excel (nëse krijohen mundësi teknike edhe ne SPSS) për përpunimin dhe analizimin e rezultateve. Si për ligjërata ashtu edhe për ushtrime, studentët inkurajohen që paraprakisht të hulumtojnë dhe lexojnë materiale rreth temave vijuese , në mënyrë që të jenë më të përgatitur në orë të mësimit.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi do të bëhet duke përmbledhë suksesin në disa aktivitete si: - për pjesëmarrje e në ushtrime dhe ligjërata – deri 5% - për angazhim në ushtrime dhe ligjërata – deri 5% - për realizim e detyrave-projekteve në mbledhjen, dhe përpunimin e të dhënave dhe prezantimin e rezultateve – deri 10% - Kollokviumi i parë---40% - Kollokviumi i dytë---40% - Provimi final ---80%
Literatura	
Literatura bazë:	- Rahmije Mustafa - Topxhiu: HYRJE NË STATISTIKË, Prishtinë, 2016

Literatura shtesë:	- Ajet Ahmeti, Statistikë për biznes dhe ekonomiks, 2016 - Prem S. Man, Introductory Statistics, Seventh Edition, John Wiley & Sons, 2010, USA, -

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	**Ligjërata që do të zhvillohet (Libri: HYRJE NË STATISTIKË)**
Java e parë:	**HYRJE** - Prezantimi i lëndës, - Metodat e punës dhe vlerësimit; - Obligimet e dyanshme student-mësimdhënës.
Java e dytë:	**KAPITULLI 1:** KUPTIMI DHE RËNDËSIA E STATISTIKËS 1.2 Çfarë kuptojmë me Statistikë? 1.3 Llojet e Statistikës 1.4 Konceptet kyçe në analizën statistikore 1.5 Të dhënat statistikore 1.6 Grumbullimi i të dhënave dhe Burimet e të dhënave statistikore 1.7 Pak histori për statistikën 1.8 Përdorimi i kompjuterëve në statistikë **Faqe 19-65**
***Java e tretë*:**	**KAPITULLI 2:** PËRMBLEDHJA DHE GRUPIMI I TË DHËNAVE STATISTIKORE - SHPËRNDARJA E FREKUENCAVE DHE PARAQITJET GRAFIKE 2.2 Përmbledhja dhe grupimi i të dhënave statistikore 2.3 Organizimi (grupimi) dhe prezantimi grafik i të dhënave cilësore 2.4 Organizimi (grupimi) dhe prezantimi grafik i të dhënave sasiore **Faqe 67-98 & 107-119**
Java e katërt:	**KAPITULLI 2:** PËRMBLEDHJA DHE GRUPIMI I TË DHËNAVE STATISTIKORE - SHPËRNDARJA E FREKUENCAVE DHE PARAQITJET GRAFIKE 2.5 Disa paraqitje të tjera grafike të të dhënave 2.6 Tabelat e kryqëzuara **Faqe 98-119**
Java e pestë:	**KAPITULLI 3:** MATËSIT E TENDENCËS QENDRORE - MADHËSITË MESATARE 3.2 Madhësitë mesatare- kuptimi 3.3 Mesatarja aritmetike për të dhënat e pa grupuara 3.4 Mesatarja aritmetike për të dhënat e grupuara/e ponderuar **Faqe 121- 133 & 146-152**
Java e gjashtë:	**KAPITULLI 3:** MATËSIT E TENDENCËS QENDRORE - MADHËSITË MESATARE

	3.5 Mediana (vlera e mesit) 3.6 Moda (vlera dominuese) 3.7 Lidhjet në mes të mesatares aritmetike, medianës dhe modës **Faqe 133 – 142 & 146-152**
Java e shtatë:	**Kollokviumi i parë**
Java e tetë:	**KAPITULLI 4:** TREGUESIT E VARIACIONIT DHE TREGUES TË TJERË TË PËRSHKRIMIT TË TË DHËNAVE 4.2 Pse duhet të studiohet variacioni apo shpërndarja ? 4.3 Treguesit e variacionit për të dhënat e pagrupuara 4.4 Treguesit e variacionit për të dhënat e grupuara **Faqe 153-168**
Java e nëntë:	**KAPITULLI 4:** TREGUESIT E VARIACIONIT DHE TREGUES TË TJERË TË PËRSHKRIMIT TË TË DHËNAVE ***OUTLIERËT*** **Faqe 169-195**
Java e dhjetë:	**KAPITULLI 13:** NUMRAT INDEKSORË 13.2 Kuptimi i indekseve 13.3 Indekset individuale (të thjeshta) 13.4 Indekset individuale dhe agregate të çmimeve **Faqe 559-578**
***Java e njëmbëdhjetë*:**	**KAPITULLI 13:** NUMRAT INDEKSORË 13.5 Indekset agregate të ponderuara të sasisë dhe indeksi i vlerës (shpenzimeve) 13.6 Disa forma të veçanta të indekseve agregate dhe aplikim i tyre 13.7 Norma mesatare e ndryshimit- mesatarja gjeometrike e indekseve vargorë. **Faqe 578-597**
***Java e dymbëdhjetë*:**	**KAPITULLI 14:** ANALIZA E SERIVE KOHORE DHE PARASHIKIMI 14.2 Përbërësit e serive kohore - 14.3 Vlerësimi i prirjes dhe parashikimit me metodën e trendit **Faqe 497-520**
***Java e trembëdhjetë*:**	Përdorimi i "Statistikave përshkruese" në Excel
***Java e katërmbëdhjetë*:**	**Kollokviumi i dytë**
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	Prezantim i punimeve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Pjesë nga Statuti i Përkohshëm i UKZ: Neni 127 1. **Studentët** që janë të pranuar në Universitet **kanë të drejtë**: 1.1. Të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminaret dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve; 1.2. Të shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe shërbimet tjera për studentë; 1.3. --------- 1.4. Studentët gëzojnë të drejtën për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga universiteti; 1.5. Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e universitetit; 1.6. ------- Neni 128 1. **Studentët** që janë të pranuar në Universitet **kanë detyrim:** 1.1. T'i respektojnë rregulloret e lëshuara nga Universiteti; 1.2. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë; 1.3. T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike; 1.4. Të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve; 1.5. Të sillen mirë si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskreditua Universitetin; 1.6. Të respektojnë rregullat e kodit etik;